

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përberë nga gjyqtarët Nebojsha Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësit S. S. nga fshati, Komuna e Sh. të cilin me autorizim e përfaqëson E. A., avokat nga P., kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkak të heshtjes administrative, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AA.UZH.nr.493/2017 të datës 18.01.2018, në seancën e mbajtur më 30.05.2018, mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. Pranohet si e bazuar kërkesa e paditësit S. S., për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.UZH.nr.493/2017 të datës 18.01.2018.

II. Prishen, aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, AA.UZH.nr.493/2017 i datës 18.01.2018 dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative A.U.nr.1525/2015 i datës 20.09.2017, ndërsa lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr. 493/2017 dt. 18.01.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit S. S., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.U. nr.1525/2015 datë 20.09.2017, me të cilin është hedhë poshtë si e parakohshme padia e paditësit për shkak të heshtjes administrative nga ana e të paditurit.

Paditësi i ka paraqitur kësaj Gjykate kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, duke theksuar se i njejtë është marrë me shkelje procedurale dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, duke propozuar që të miratohet si e bazuar kërkesa, dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.493/2017 dt.18.01.2018 të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të miratohet si e bazuar, ose aktvendimi i kontestuar të priset dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancën në përputhje me nenin 53 të LKA, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar, vlerësoi pretendimet e paraqitur në kërkesë dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës konstatoi:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA.UZH. nr.493/2017 dt. 18.01.2018 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit S. S., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative A.U.nr.1525/2015 datë 20.09.2017, me të cilin është hedhë poshtë si e parakohshme kërkesëpadia e paditësit për shkak të mosveprimit (heshtjes administrative) të palës së paditur.

Lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme gjeti se tani për tani nuk mund të pranohen si të drejta pikëpamjet juridike të gjykatave të instancave më të ulëta të paraqitura në aktvendimet e tyre, të cilat janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të LKA, dhe për këtë arsye të dy aktvendimet u prishën.

Gjykata Supreme konsideron se gjykatat e instancave me të ulëta kanë kryer shkelje thelbësore të dispozitave të parashikuar nga neni 182 par.2 pika (n) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të zbatuar sipas nenit 63 të LKA. Kështu, në nenin 182 par.2 pika (n) të LPK parashikohet që shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë kur aktgjykimi ka të meta të tilla për të cilat nuk mund ekzaminohet, sidomos kur nuk përmban fare arsye ose kur nuk ka arsye për faktet vendimtare ose kur arsyet e paraqitura janë të paqarta, kontradiktore apo kur lidhur me faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie ndërmjet asaj që thuhet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së dokumenteve ose procesverbaleve. Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se gjykatat e instancave me të ulëta nuk kanë parashtruar në aktvendimet e tyre se cilat faktet vendimtare janë të vërteta dhe ku e mbështesin vlerësimin e tyre, ndërkohë që arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kundërthënëse. Përveç kësaj kakundërthënie edhe ndërmjet asaj që thuhet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e dokumenteve.

Kështu, gjykata e shkallës së parë nxjerrë aktvendimin A.U.nr.1525/2015 dt.20.09.2017 me të cilin e hedhë poshtë kërkesëpadinë e paditësit të parashtruar me datë 27.08.2015. Në arsyetimin e këtij aktvendimi gjykata në procedurë të shqyrtimit paraprak të padisë, me datë 31.01.2017 e ka ftuar paditësin që ta rregullojë padinë, ndërsa paditësi me datë 08.02.2017 ushtron parashtrësë për korigjimin e padisë. Bazuar në këtë, mbetet e paqartë nëse gjykata e shkallës së parë e ka hedhë poshtë padinë e paditësit të datës 27.08.2015 siç u vendos në dispozitivin e saj, apo është hedhë poshtë precizimi i kërkesëpadisë i datës 08.02.2017 sipas konkludimeve në arsyetim të aktvendimit. Ajo që vlen të theksohet është fakti se kërkesëpadia e paditësit është dorëzuar në gjykatë me 27.08.2015, ndërsa gjykata e shkallës së parë në procedurë të shqyrtimit paraprak të padisë, me datë 31.01.2017 ia kthen padinë paditësit që të bëjë plotësimin e saj, që do të thotë nga momenti i paraqitjes së padisë deri te thirrja për të bërë rregullimin e padisë kanë kaluar dy vjet e pesë muaj, ndërsa gjykata nuk ka ndërmarrë asnjë

veprim procedural për ta zgjidh çështjen. Më tej, në shkresat e lëndës mungojnë ekzemplarë të akteve administrative të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë. Situata juridike bëhet krejtësisht e paqartë se si gjykatat instanciale kanë konkluduar se kërkesëpadia e paditësit është e parakohshme, meqenëse paditësi ka kërkuar me padi dhe me padi të korrigjuar të bëhet konstatimi i heshtjes administrative. Poashtu, gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me këtë çështje administrative, edhe pse bëhet fjalë për mosveprim të procedimit - më shumë se dy vjet, ka nxjerrë një aktvendim procedural me të cilin e ka hedhur poshtë padinë e paditësit, pa e shqyrtuar mundësinë për të vendosur në mënyrë meritore.

Përveç kësaj, gjykata e shkallës së parë u bazua në dispozitat e Ligjit mbi Konfliktet Administrative, respektivisht në nenin 13 par. 1 dhe 2 ku përcaktohet se konflikti administrativ mund të zhvillohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë dhe se konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurë administrative ankimi nuk është i lejuar, e më pas kjo Gjykatë thekson se padinë e paditësit e ka hedhë poshtë si të parakohshme, në kuptim të nenit 34.1 pika 1.1 të LKA-së, përkundër faktit se paditësi ka kërkuar që të konstatohet mosreagimi i administratës apo heshtja e saj konform nenit 29 par 1 dhe 2 të LKA-së.

Gjykata Supreme tani për tani nuk mund ti pranojë si të drejta pikëpamjet e lartëpërmendura të gjykatave të instancave më të ultë, sepse në aktvendimet e tyre ato nuk i kanë paraqitur arsyet për faktet vendimtare, kurse arsyet e paraqitura janë të paqarta dhe kontradiktore, dhe në të njëjtën kohë ka edhe kundërthënie ndërmjet arsyesimit të aktvendimeve dhe përmbajtjes së dokumenteve. Gjykata e shkallës së dytë me aktvendimin e saj AA.UZH.nr.493/2017 dt.18.01.2018 e ka vërtetuar aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Themelore (A.U.nr.1525/2015) dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, me këto veprime joligjore gjykatat kanë bërë shkelje procedurale pasi që në vendimet e tyre nuk i kanë paraqitur arsyet se cilat faktet vendimtare janë të vërteta dhe ku e mbështesin vlerësimin e tyre, ndërkohë që arsyet e tyre janë të paqarta dhe kundërthënëse. Për arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vendosi ti prishë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën t'ia kthen gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje.

Në riprocedimit, gjykata e shkallës së parë duhet ti mënjanojë të metat e përmendura më lartë dhe të vërtetojë faktet dhe provat që lidhen me pretendimet e paraqitura në padi e në parashtesë për korrigjimin e padisë, dhe varësisht nga gjendja faktike që do të vërtetohet, me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, të vendos drejtë, në mbështetje të ligjit dhe në mënyrë meritore mbi padinë e paditësit. Gjykata e shkallës së parë duhet tu kushtojë kujdes të veçantë lidhur me mosveprimin administrativ të organit të shkallës së parë, madje edhe mosdorëzimin eventual të ankesës së paditësit organit administrativ të shkallës së dytë – në këtë rast të paditurës MMPH. Poashtu, është e nevojshme të sigurohen të gjitha shkresat e lëndës nga organi administrativ i shkallës së parë, por edhe nga ai i shkallës së dytë (në rast se ky organ ka vepruar sipas ankesës së paditësit), dhe varësisht nga gjendja faktike që do të vërtetohet, me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, të vendos drejtë dhe në mënyrë meritore. Gjykata e shkallës së parë duhet të kushtojë kujdes të veçantë lidhur me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 54 par.2 e 3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
ARJ.UZVP.nr.41/2018, më datë 30.05.2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Nebojsa Boriçiq

Përktheu: F. A.